



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIQ - MUNICIPALITY OBILIQ

Nr. Bër. No. 01-060-01-21563-24

Nr. I fq./Brast./Nëntq.

Data /Datum/ Data

OBILIQ - OBILIÇ - OBILIC

31.09.2024



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit

STATUTTI I ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ/2024

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E STATUTIT TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ/2021

Obiliq, 2024

Në mbështetje të nenit 12 (paragrafi 1 dhe 2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 4 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 nën- nënparagrafi 1.1.2), neni 5 (paragrafi 2) dhe të Ligjit NR. 08/L-245 Për Artin Dhe Kulturën, bazuar në Vendimin Nr. 226/2019 të datës 27/12/2019, neni 38 (paragrafi 1) dhe neni 44 (paragrafi 2 nënparagrafi 2.1) bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-1-34, të dt.25.04.2016, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-1-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.26.07.2024 miraton:

STATUTI I ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ/ 2024

PËR PLOTËSIM NDRRYSHIMIN E STATUTIT TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ/2021

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Statut përcaktohet dhe konkretizohet themelimi, statusi veprimtaria, mandati, historiku i veprimtarisë, selia, llogu, vula, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, financimi dhe çështjet tjera të rëndësishme themelore për organizimin dhe funksionimin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Obilic.

Neni 2

Themelimi dhe statusi

1. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obilic, është themeluar dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr.04/L – 164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe ansambleve tjera, Vendimin Nr. 226/2019 të datës 27/12/2019 të Kuvendit të Komunës së Obilicit si dhe me këtë Statut.

2. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obligq si institucion lokal i kulturës, themelohet duke u bazuar në mandatin dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës, dhe funksionon në kuadër të drejtorisë përkatëse për kulturë në Komunën e Obligqit.
3. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obligq, është institucion publik me veprimtari të përcaktuar në aktet juridike normative, në kuadër të personalitetit juridik të Komunës së Obligqit si institucion vartës i Komunës.
4. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obligq, është institucion kulturor i pavarur nga organizimet politike dhe apo organizimet tjera që kanë për qëllim grupe të veçanta të interesit.

Neni 3

Emërtimi, selia, vula dhe logo

1. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obligq, ka emërtimin zyrtar dhe formën e shkurtër të përdorimit të emrit. Emërtimi zyrtar i këtij institucioni është: “Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obligq” ndërsa emërtimi në formën e shkurtër/akronimi është “AKV Obligq”.
2. AKV Obligq e ka selinë e vet përkatësisht funksionon në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës, “Xhavit Haziri” në Obligq.
3. AKV Obligq mund të funksionojë në një lokacion tjetër të përcaktuar me Vendim të drejtorisë përkatëse për kulturë, përkatësisht organeve drejtuese të Komunës së Obligqit.
4. AKV Obligq ka Logon, Vulën e rumbullakët dhe Vulën katrore.
5. Logo e AKV Obligq është e dizajnuar në formë rumbullake e kufizuar me rreth, në mes janë tre personazhe: dy vallëtarë dhe një dautlexhi duke përshkruar vallëzimin dhe apo ilustrimin e muzikës si dhe simbolikën e kostumeve kombëtare. Logoja përbëhet nga dy

ngjyra: bardhë dhe zi dhe në të përfshihet mbishkrimi në tre gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze, gjegjësisht: “Ansambl i Këngëve dhe Valleve Obiliq”, “Ensemble of Songs and Dance Obiliq”, “Ansambl Pesama i Igara Obiliq”.

6. Përmbajtja e Logos, vulës katrore dhe asaj rrumbullake, është e përcaktuar me këtë Statut dhe është shtojcë e veçantë e këtij Statuti.

Neni 4 Misioni

1. Misioni i Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Obiliq përfshinë:

1.1. Ruajtjen, kultivimin, zhvillimin dhe prezantimin e traditës muzikore, përkatësisht këngëve, valleve, dokeve, zakoneve, kostumeve dhe instrumenteve burimore si kategori me rëndësi të veçantë të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe apo materiale.

1.2. Prezantimi dhe afirmimi dinjitoz i këtyre vlerave brenda dhe jashtë vendit;

1.3. Zhvillimi i komponentës së edukimit kulturor dhe artistik për, dhe rreth vlerave të kulturës, traditës dhe shprehjeve artistike që hyjnë në mandatin e Ansamblit.

1.4. Ruajtjen, kultivimin, zhvillimin dhe prezantimin e traditës muzikore, përkatësisht këngëve, valleve, dokeve, zakoneve, kostumeve dhe instrumenteve burimore si kategori me rëndësi të veçantë të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe apo materiale.

1.5. Prezantimi dhe afirmimi dinjitoz i këtyre vlerave brenda dhe jashtë vendit;

Neni 5 Vizioni

1. Vizioni i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Obiliq, përfshinë:

- 1.1. Hartimin dhe propozimin e komponentëve të veçanta të politikës programore për zhvillimin e Ansambllit pranë drejtorisë përkatëse për kulturë dhe organeve tjera të Komunës;
- 1.2. Zbatimin efikas të objektivave strategjike dhe politikave programore të drejtorisë përkatëse për kulturë dhe organeve tjera të Komunës;
- 1.3. Realizimin e projekteve që pasqyrojnë identitetin dhe vlerat kombëtare si dhe diversitetin kulturor;
- 1.4. Përgatitja, ngritja dhe promovimi i kuadrove të reja përmes formave të ndryshme të përfshirjes së këtyre kuadrove në aktivitetet e ansambllit për qëllime të edukimit dhe

Neni 6 Veprimtaria

1. Veprimtaria e Ansambli të Këngëve dhe Valleve Obligë është me interes të veçantë publik.
2. Veprimtaria themelore e ansamblit mbi bazën e së cilës organizohet funksionimi i gjithëmbarshtëm i tij, përfshin: rrafshin, krijimin dhe promovimin e vlerave kulturore si: këngë, valle, kostume dhe instrumente burimore. Veprimtaria e AKV Obligë përfshinë:
 - 2.1. rrafshin e traditës muzikore kombëtare;
 - 2.2. shtfaqjen publike të koncerteve dhe formave tjera skenike – muzikore;
 - 2.3. organizimin dhe realizimin e koncerteve të traditës shpirtërore;
 - 2.4. konservimin dhe arkivimin e lëndës muzikore të traditës shpirtërore e materiale të veçanta, si dhe rritjen, zhvillimin, avancimin, publikimin dhe promovimin e artit kombëtar brenda dhe jashtë vendit.
3. Ansambli në kuadër të realizimit të veprimtarisë së tij, bashkëpunon me institucionet dhe organizata tjera kulturore homologe, publike dhe jo publike, vendore dhe ndërkombëtare.
4. Bashkëpunimi me institucione, asociacione e organizata si në paragrafin tre (3) të këtij neni, do të zhvillohet në formën e krijimit dhe realizimit të të gjitha aktiviteteve dhe programeve që janë pjesë e mandatit të ansamblit duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Historiku i veprimtarisë kulturore artistike e këngëve dhe valleve në Komunën e Oblitit

1. Veprimtaria kulturore artistike e këngëve dhe valleve në Komunën e Oblitit, ka zanafillën e saj që nga koha e funksionimit të Qendrës së Kulturës para vitit 1962, kur Obliti e kishte statusin e Komunës.
2. Pas vitit 1962, kur Obliti e kishte humbur statusin e Komunës. Qendra e Kulturës ishte transferuar në kuadër të ish Kombinatit Xehtar Energetik. Brenda strukturës së Qendrës së Kulturës, kishte funksionuar dhe ishte zhvilluar me sukses edhe seksioni i këngëve dhe valleve.
3. Veprimtaria kulturore artistike e këngëve dhe valleve në Komunën e Oblitit, kishte vazhduar edhe pas vitit 1990 përkatësisht pas vendosjes së masave të detyrshme, përmes formave të ndryshme të organizimit në rrethanat e asaj periudhe historike, politike e shoqërore.
4. Pas vitit 1999, veprimtaria kulturore dhe artistike e këngëve dhe valleve në Komunën e Oblitit, zhvillohet në kuadër të formave të organizimit në sektorin jo qeveritar.
5. Me themelimin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Oblit, me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Oblitit Nr. 226 të datës 27.12.2019 dhe me këtë Statut, veprimtaria kulturore artistike e këngëve dhe valleve avancohet në nivel të shërbimit me interes publik në kuadër të Komunës, dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin në fuqi për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe ansamblet tjera.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ

Neni 8

Organizimi i AKV Obiliq

1. Struktura organizative e AKV Obiliq përbëhet nga:

1.1. Drejtori i Ansambllit dhe;

1.2. Këshilli Artistik i Ansambllit.

Neni 9

Drejtori i AKV Obiliq

1. Drejtori i AKV Obiliq, është udhëheqës i Ansambllit.

2. Drejtori zgjidhet përmes konkursit publik të cilin e organizon Drejtoria përkatëse për kulturë e Komunës së Obiliqit.

3. Drejtori duhet të ketë diplomë universitare në fushën e artit dhe- apo të kulturës, si dhe me përvojë pune që ndërrihet me këtë fushë.

4. Mandati i drejtorit është pesë (5) vjeçar, me mundësi të vazhdimit për vetëm edhe një mandat tjetër.

5. Nese pas përfundimit të mandatit të parë drejtori i institucionit publik lokal ka vlerësim pozitiv për punën dhe performancën gjatë mandatit, drejtori komunal përkatës për kulturë në konsultim me Këshillin artistik të institucionit përkatës mund t'i rekomandojnë kryetarit të Komunës ofimin e mandatit të dytë për drejtorin pa shpallur konkursin publik.

6. Drejtori i institucionit publik lokal të artit dhe kulturës mund të shkarkohet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të ansambllit

1. Është përfqësues i institucionit;
2. Drejton veprimtarinë artistike, kulturore, administrative dhe organizative, bazuar në programin për udhëheqjen e institucionit;
3. Administron burimet financiare dhe njerëzore të institucionit;
4. Kryen të gjitha detyrat e tjera që t'i ngarkon ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 11

Përbërja, emërimi, shkarkimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Artistik

1. Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obilij, ka Këshillin Artistik i cili ka rol këshillues për drejtorin dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 1.1 këshillon drejtorin në hartimin e programit artistik;
 - 1.2. mbështet drejtorin në realizimin e programit artistik.
2. Këshilli Artistik përbëhet nga (tre) anëtarë.
3. Anëtarët e Këshillit artistik duhet të jenë personalitete të njohura të artit dhe kulturës me integritet personal dhe profesional.
4. Të drejtë propozimi për një (1) anëtar të këshillit artistik të institucionit publik lokal kanë:
 - 4.1. kryetari i komunës;
 - 4.2. drejtori i institucionit;
 - 4.3. komuniteti artistik lokal.
5. Mandati i këshillit artistik është pesë (5) vjeçar.
6. Këshilli artistik emërohet me vendim të kryetarit të Komunës.
7. Anëtarët e Këshillit artistik mund të shkarkohen me kërkesën e arsyetuar të propozuesit.

8. Me vendim të drejtorit të AKV Obliq, Këshilli Artistik, mund ndryshohet/plotësohet para përfundimit të mandatit, pas vlerësimit të për performancës dhe nivelit të kryerjes së detyrave të përcaktuara me këtë Statut dhe aktet tjera normative në fuqi.
9. Këshilli Artistik harton raporte, analiza dhe rekomandime periodike tre (3) mujore dhe vjetore për realizimin me sukses të planeve dhe programeve të punës dhe apo artistike të Ansambliit.

Neni 12

Financimi

1. AKV Obliq, financohet nga buxheti i Komunës së Obliqit.
2. Institucionet publike të artit dhe kulturës kanë kode të veta buxhetore.
3. AKV Obliq, në funksion të realizimit të plotë të veprimtarisë dhe mandati të tij, përgatitë projekte e propozime konkrete me të cilat aplikon për financim në programet e Ministrisë përkatëse për kulturë, në përputhje me programin e tij artistik si dhe strategjitë dhe politikat sektoriale të fushës së kulturës, përgjigjësis për zbatimin e të cilave, është Ministria përkatëse për kulturë.
4. AKV Obliq financohet nga burimet tjera duke përfshirë donacionet e organizatave të ndryshme vendore dhe apo ndërkombëtare si dhe subjekteve tjera në përputhje me ligjet dhe aktet tjera normative në fuqi.
5. AKV Obliq mund të financohet edhe nga të hyrat vetanake të cilat do të përdoren në bazë të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe në marrëveshje me institucionet përkatëse që kanë mandat mbikqyrjen e shpenzimeve publike.

Neni 13

Fondusi

Ansambli i Këngëve dhe Valleve Obliq ka fondusin e vet dhe obligohet që t'i ruaj kostumet, instrumentet muzikore, rekuizitat, elementet skenografike si dhe materialet tjera me vlerë etnomuzikologjike.

Neni 14
Arkiva

Përveç materialit arkivor për ruajtjen e të cilit institucionet publike obligohen me legjislacionin për arkivat shtetërore dhe legjislacionin tjetër për administrimin e punës në zyrë, AKV Oblig, në arkivën e tij, siguron ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e materialeve të veçanta arkivore me rëndësi për veprimtarinë e tij.

Materialet arkivore me rëndësi të veçantë për veprimtarinë artistike të Ansambli mund të jenë: repertoari koreografik, struktura e projekteve koreografike dhe shfaqjeve koreografike, kompozicioni muzikor i koreografisë, regjistrimet dhe dokumentimet audiovizuale, plaketa, katalogje, material fotografik, publikimet në mediat e shkruara.

KATEGORITË E TË PUNËSUARVE NË ANSAMBLIN E KËNGËVE DHE VALLEVE OBILIQ

Neni 15
Staffi administrativ dhe teknik

1. Përveç stafit udhëheqës dhe artistik, AKV Oblig, ka edhe shërbimin administrativ në kuadër të strukturës së përgjithshme të të punësuarve.
2. Staffi administrativ dhe teknik është përgjegjës për kryerjen e detyrave dhe funksioneve mbështetëse, administrative dhe teknike që mundësojnë funksionimin e përhershëm të Ansambli.

3. Struktura, rekrutimi, organizimi dhe funksionimi i shërbimit të brendshëm administrativ dhe teknik, përcaktohet nga Komuna me akte normative si dhe në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për zyrarët publik me të cilin rregullohet statusi, organizimi, funksionimi dhe rekrutimi i zyrarëve publik në Republikën e Kosovës.

Neni 16

Trupa artistike

1. Në kuadër të strukturës së Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Obligë, përveç organeve drejtuese dhe njësi të tjera të përcaktuara me ligj, është funksionale trupa artistike e cila ka përgjegjësinë e realizimit artistik të veprimtarisë së Ansambllit;

1. Trupa artistike përbëhet nga:

1.1. Staf i udhëheqës artistik;

1.2. Valltarët, instrumentistët, solistët vokal dhe kori;

1.3. Staf i artistik – teknik.

Neni 17

Përbërja e stafit udhëheqës artistik

1. Staf i udhëheqës artistik përbëhet nga:

1.1. Koreografi;

1.2. Koreopetitori;

1.3. Udhëheqësit e seksioneve si:

1.3.1. Seksionit të valleve;

1.3.2. Seksionit të orkestrës;

1.3.3. Seksionit të solistëve vokal.

2. Në kuadër të stafit udhëheqës artistik mund të përfshihen edhe pozita të tjera me funksione udhëheqëse të cilat mund të parashikohen me organizimin e brendshëm të Ansambli të nuk janë aparaturë në paragrafin një (1) të këtij neni.

Neni 18

Statusi dhe funksionimi i trupës artistike dhe i stafit tekniko artistik

1. Anëtarët e trupës artistike dhe të stafit artistik – teknik, kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik në kuptim të ligjit në fuqi për zyrtarët publik.
2. Struktura, rekrutimi, organizimi, funksionimi dhe gradimi i anëtarëve të trupës artistike dhe i stafit artistik – teknik, përcaktohet me akte nënligjore të cilat miratohen nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Bashkëpunimi me artistë dhe bashkëpunëtorët tjerë të jashtëm

1. Përveç trupës artistike të përhershme, e cila ka përgjegjësinë themelore për realizimin artistik të veprimtarisë së vet, AKV Obiliq, në kuadër të programeve dhe apo projekteve të fushës së veprimtarisë së tij, siguron bashkëpunim dhe angazhim sipas nevojës edhe të artistëve e bashkëpunëtorëve tjerë të jashtëm përmes procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Bashkëpunimi dhe apo angazhimi si në paragrafin një (1) të këtij neni, planifikohet dhe realizohet atëherë kur një gjë e tillë i shërben ngritjes dhe avancimit të nivelit të përfaqësimit të vlerave krijuese dhe performuese që hyjnë në fushëveprimin e mandatit të AKV Obiliq.

Neni 20
Organizimi i brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i Ansambli të Këngëve dhe Valleve Oblig, duhet të reflektojë mandatin dhe veprimtarinë e tërësishtme të Ansambli, të përcaktuar me këtë Statut.
2. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i AKV Oblig, përcaktohet me akt të veçantë nenligjor të bazuar në Ligjin NR.08/L-245 Për Artin Dhe Kulturën, Ligjin NR.08/IL-197 për Zyrtarët Publik, Nr. 03/L – 030 për Vetëqeverisje Lokale si dhe Statutin e Komunës së Obligut të miratuar nga Asambleja e Komunës së Obligut.

Neni 21

Konflikti i interesit

Konflikti i interesit, për të gjitha kategoritë e të punësuarve në strukturën e përgjithshme të Ansambli të Këngëve dhe Valleve Oblig, rregullohet dhe trajtohet në përputhje me Ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit.

Neni 22

Shfuqizimi

Me këtë Statut, ndryshohen dispozitat ligjore të nenit 9, 10, 11, të Statutit të Ansambli të Këngëve dhe Valleve Oblig Nr. I-18, të datës 29.01.2021, kurse janë plotësuar nenet 13, 21, 23, 24 të cilat do të zbatohen vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij dokumenti.

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi ditën e parë, pas afarit të përcaktuar për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunave.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal;



Vlora Mjekiqi Kabashi

Korrik, 2024

